



Pranimi / Dostizimi Prilpice / Pristato Received / Delivered	07. 10. 2022	2	viti qad Year
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org. Unit	Nr. Prot in Prot Prot No	Shifra e Protog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	5965/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.733/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.733/2022 të datës 24.08.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë: kundër Vendimit me Nr.prot:1174/2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 26.07.2022, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 07.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.733/2022 e datës 24.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.prot:1174/2022 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 26.07.2022.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ), pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat ve datë 29.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli:2521/2022 të regjistruar me numër A.nr.432/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër

Vendimit me Nr.prot:1174/2022 të datës 26.07.2022 të Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se me rastin e transferimit të përkohshëm të ankuesit, institucioni punëdhënës ka shkelur parimet e menaxhimit të zyrtarëve publik, ka bërë shkelje procedural dhe materiale të dispozitave ligjore të ligjit material, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 01.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën, ndërsa më datë 15.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:4941/2022 të regjistruar me numër të datës 24.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.prot:1174/2022 të Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 26.07.2022; Autorizimin e datës 22.11.2022; Akt emërimit e ankuesit të datës 03.10.2016 me numër prot:90.2016; Vendimin e Këshillit A.nr.432/2022 të datës 23.06.2022; Vendimin e Njësia së Burimeve Njerëzore të MPB-së të datës 22.07.2022; E-mailin e datës 25.07.2022 dërguar nga Njësia e personelit të MPB-së për ankuesin; Vërtetimin e lëshuar nga Policia e Kosovës me datës 22.08.2022 për ankuesin; Listën e pagës së ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Departamentit për Trajnime dhe Përkrahje Arsimore; Diplomën e ankuesit të datës 15.05.2014 me numër:607; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.09.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 15.09.2022 me shkresat e bashkëngjitura; Përgjigjen në ankesë me numër:1456/2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e Drejtorit të DSPIMNQ;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, bazuar në shkesat e administruara të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 03.10.2016 është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *Drejtor i Departamentit për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ)* në Ministrinë e Administratës Publikë, tani Ministria e Punëve të Brendshme.

Po ashtu, sipas shkresave të lëndës sikurse dhe shkresave që disponon Këshilli për rastin nga baza e të dhënave arkivore, ka gjetur se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes Vendimit me Nr.597/2022 të datës 08.04.2021, ankuesit i kishte shqiptuar masën disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil"*, ndërsa Këshilli përmes Vendimit A.nr.432/2022 të datës 23.06.2022 e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke e ndryshuar vendimin e Komisionit Disiplinor, respektivisht duke ia ndryshuar masën disiplinore, me konfirmimin e masës tjetër në shërbimin civil, *"Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e*

pagesë për një periudhë prej tri (3) viteve” mirëpo ankuesit, Këshilli i kishte njohur të drejtën e kthimit në vendin e tij të punës sipas aktit të emërimit datës 03.10.2016, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme përmes vendimit të datës 22.07.2022 e kishte zbatuar vendimin e Këshillit A.nr.432/2022 duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës sipas akt emërimit të datës 03.10.2016.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar Vendimin me Nr.prot:1174/2022 të datës 26.07.2022 të nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes të cilit ankuesi një ditë pasi që ditë është kthyer në vendin e tij të punës është transferuar përkohësisht për interes të institucionit nga data 26.07.2022 deri me datë 25.01.2023 në pozitën “Drejtor i Departamentit të Trajnimeve dhe Përkrahjes Arsimore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publikë” me arsyetimin se, **citoj:** “... meqenëse është gjetur se mban përgjegjësi disiplinore për shkelje disiplinore, përfshirë këtu mos përmbushjen e detyrave të punës, moszbatim i dispozitave ligjore për përmbushjen funksionale si dhe shkelja e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi jo vetëm Komisioni Disiplinor i MPB-së si shkallë e parë por është vërtetuar pjesërisht edhe nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si organ Mbikëqyrës-si dhe për arsye se si rezultat i këtyre shkeljeve të detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe duke u bazuar në të gjeturat e raportit të Auditimit të Brendshëm të MPB-së në këtë periudhë ndaj Departamentit për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare janë duke u zhvilluar hetime penale, e për shkak se Drejtori i së cilit sipas akt emërimit Ministria e Punëve të Brendshme e ka vlerësuar si të nevojshme dhe të domosdoshme që të bëjë transferimin e përkohshëm të z. ...”.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e ligjit material që përcaktojnë kushtet dhe rrethanat mbi bazën e të cilat mund të realizohet transferi i përkohshëm i nëpunësve civil, respektivisht nenin 52 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve” si dhe nenin 5 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e nëpunësve Civil ku përcaktohet se: “Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit. Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, të ndryshëm nga institucioni ku ai është i emëruar, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm duhet të marrë paraprakisht miratimin e institucionit ku nëpunësi civil është i punësuar. 2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet”, dhe ka ardhur në përfundimin se është në të drejtën e institucionit që të bëjë transferimin e nëpunësve civil, mirëpo për rastin e ankuesit Kolegji i Këshillit konstaton faktin se nuk janë përmbushur parakushtet e caktuara të ligjit material dhe rregullores në fjalë, ngase në aspektin procedural sipas dispozitave të kësaj rregullore është dashur të ketë kërkesë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike me rastin e transferimit të ankuesit, ngase pavarësisht që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është institucion i ndryshëm nga ai në të cilën është i emëruar ankuesi, gjegjësisht institucioni respektiv funksionon ndaras në kuptim të organizmit dhe funksionimit të brendshëm lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë që i



garantohen sipas ligjit, madje Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka edhe njësi të pavarur për menaxhimin e burimeve njerëzore ndaras nga ajo e MBP-së, dhe po ashtu me rastin e transferimit të ankuesit, Njësia e Burimeve Njerëzore të MPB-së ka dështuar të konstatoi faktin se a i plotëson ankuesi kriteret e pozitës së punës ku ai kërkohet të transferohet, ngase i njëjti sipas Diplomës së datës 15.05.2014 ankuesi mban titullin Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës, ndërsa qëllimi i pozitës së punës në të cilin është transferuar ka të bëjë me: *“Siguron një cilësi me standarde të larta për trajnimin dhe aftësimin profesional me një qasje transparente dhe të qëndrueshme në përmbushjen e nevojave të përkrahjes arsimore për të gjithë pjesëmarrësit pranë akademisë”*, nga rrjedh se përvoja e punës dhe kualifikimi i të njëjtit janë të ndryshëm me atë që kërkohet dhe është e nevojshme të arrihet në pozitën ku është transferuar.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se arsyetimi përdorur nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Vendimin e datës 26.07.2022 përmes të cilit ankuesi është transferuar përkohësisht në interes të institucionit nuk është në frymën e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ngase lidhur me zbatimin ose mos zbatimin e detyrave të punës nga ana e nëpunësve civil gjegjësisht ankuesit, Këshilli përmes Vendimit me numër A.nr.432/2022 të datës 23.06.2022 ankuesit i ka konfirmuar masën disiplinore *“Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë prej tri (3) viteve”* dhe se të njëjtat shkelje disiplinore nuk mund të shërbejnë apo nuk mund të përdoren si arsyetim me qëllim të transferimit të nëpunësit pasi që dispozitat e ligjit material në kuptim të nenit 47 nuk kanë parashikuar një masë të tillë disiplinore, dhe po ashtu ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ka ofruar në cilësi të provës material Vërtetimin e lëshuar nga Policia e Kosovës me datë 22.08.2022 përmes të cilit vërtetohet se ankuesi i datës së lindjes 10.06.1974 me numër personal 1030638014 i vendit të lindjes Vërshec, NUK KA dosje penale në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës, nga rrjedh se arsyetimi i dhënë me rastin e transferimit nuk përkon me gjendjen faktike të dëshmuar nga ankuesi përmes shkresës së lëshuar nga Policia e Kosovës, respektivisht arsyetimi i dhënë në vendimin për transferimin e ankuesit është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret”*

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, analizimit dhe konstatimit të gjendjes faktike sikurse edhe analizimit të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me transferet e përkohshme në interes të institucionit, sikurse dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi, ka arritur të konstatojë se Vendimi me Nr.prot:1174/2022 i datës 26.07.2022 i nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit për procedurën e përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme”*, ngase njësia përgjegjëse me rastin e transferimit të ankuesit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material të konstatuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi sikurse diskrecioni i përdorur në rastin konkret është në kundërshtim me veprimet procedurale të përcaktuara me nenin 5 paragrafi 1, 2 dhe 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, andaj mbi këtë bazë vendimi i goditur përmes ankesës në

Këshill është shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë plotësisht të bazuara në lidhur me transferimin e përhershëm të ankuesit përmes vendimit të datës 26.07.2022 nga njësia përgjegjëse.

Kolegji i këshillit po ashtu me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka pasur parasysh edhe nenin 8 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, mirëpo thekson faktin se kjo normë vije në shprehje apo gjen zbatim vetëm në rastet kur transferimi bëhet përshtatshmërisht në aspektin procedural dhe faktik sikurse kërkohet me dispozitat e kësaj rregulloreje në rastin konkret për transferin e përkohshëm në interes të institucionit e përcaktuar me nenin 5 të së njëjtës rregullore, andaj Kolegji i Këshillit thekson faktin se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme sikurse dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me rastin e zbatimit të këtij vendimi, obligohen që ankuesin ta kthejnë në detyrat dhe vendin e tij të punës të përcaktuara sipas aktit të emërimit të datës 03.10.2016, pasi që me rastin e transferimit të ankuesit kanë vepruar në kundërshtim me parakushtet e përcaktuara sipas dispozitave ligjore, andaj edhe kanë vepruar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publik të përcaktuar me nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mbështetje edhe të nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e ankuesit sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.733/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokai
- Sekretarit të Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.